



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2019:125707
Datë: 01.02.2021
Numri i dokumentit: 01459354

C.nr.434/19

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Civil, Gjyqtari Malsor Kryeziu, me praktikanten e kësaj gjykate Liridona Uka, duke vendosur në çështjen juridike të paditëses L. D., nga Gjakova, Rr.”. . .” nr. . . , të cilën me autorizim e përfaqëson Korab Bokshi av. nga Gjakova, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 1,894.00 euro, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 13.01.2021, në prezencën e paditëses dhe të autorizuarit të saj, si dhe në mungesë të të paditurës, i përpiluar me datë 01.02.2021, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET kërkesëpadia e paditëses L. D., nga Gjakova dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, që paditëses të ia paguaj borxhin në emër të shpërblimit jubilar, në lartësi të një pagë bazë në shumën prej 447.75 € (katërqind e katërdhjetëeshtatë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), së bashku me kamatën ligjore 8% në vit, prej dt.13.01.2021 e deri në përmbushjen përfundimtare, krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbaramit.

II. Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditëses L. D., nga Gjakova, për shpërblim jubilar mbi shumën e aprovuar 447.75 € si në dispozitiv nën I të këtij aktgjykimi, e deri në shumën e kërkuar 671,62 €, refuzohet si e pa bazuar.

III. DETYROHET e paditura që t’ia paguajë paditëses shpenzimet procedurale dhe atë në lartësi prej 165,20 € në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbaramit me dhunë.

A r s y e t i m

Seanca kryesore është mbajtur konform nenit 423.4 të LPK-së.

Paditësja në këtë Gjykatë ka parashtruar padi për kompensimin e pagave për përcjellje në pension dhe shpërblimit jubilar, kundër të paditurës, Drejtoria e Arsimit- Komuna e Gjakovës. Në referatin e padisë dhe parashtrësës mbi precizimin e kërkesëpadisë, ka theksuar se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune në cilësinë e edukatores në institucionin parashkollor “. . .” në

Komunën e Gjakovës deri në pensionim dhe ka mbi 40 vite përvojë pune. Padiësja ka arritur moshën e pensionimit me 23.04.2019, për çka konform Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, nënshkruar nga Mashti dhe SBASH me nr. protokoli 2056 dt.18.06.2017, neni 35 par.8 pika 8.4, padiësës si shpërblim jubilar i takon të përfitoj 150% të vlerës së pagës bazë. Padiësja para pensionimit, si punëmarrëse tek e paditura ka përfituar pagë bazë në lartësi prej 447.75 euro, ashtu që 150% të pagës bazë do të bie të jetë 671.62 euro. Meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin e vet ligjor, i ka propozuar gjykatës që të merr aktgjykim të aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesë padia e padiësës L. D., nga Gjakova dhe të detyrohet e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit - Gjakovë, që padiësës të ia paguaj borxhin në emër të shpërblimit jubilar në shumën prej 671,62 €, së bashku me kamatën ligjore në lartësi prej 8%, prej datës së paraqitjes së padisë e deri në përmbushjen përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës, krejt këto në afatin prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nën kërcenim të përbarimit.

I autorizuari i padiësës në shqyrtimin kryesor ka deklaruar mbetëm në tërësi pranë padisë dhe kërkesës padisë si dhe parashtrësës se dt. 13.01.2021, si dhe provave të bashkangjitura asaj parashtrëse gjithashtu me qëllim të argumentimit të bazës së kërkesëpadisë gjykatës drejtpërdrejt ia dorëzoj edhe vendimin për mardhenjë pune. Gjithashtu gjykatës i dorëzojmë vërtetimin e lëshuar nga institucioni parashkollor “. . .” nr. 03/01/2021 e dt.12.01.2021 me të cilën vërtetohet përvoja e punës e këtu padiësës dhe lartësia e pagës në momentin e pensionit.

Ndërsa në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar nga provat e bashkangjitura në padi dhe në parashtrësë e dt.13.01.2021 si dhe provave të tjera të dorëzuar drejtpërdrejt në shqyrtim konsiderojmë se është vërtetuar baza dhe lartësia e kërkesëpadisë e cila rrjedhë në bazë të kontratës kolektive e cila kontratë është e zbatueshme edhe konform ligjit të punës ndërsa sa i përket lartësisë së kërkesës e njëjta është vërtetuar në bazë të ekstraktit të translacioneve bankare i cili është në përputhje të plot me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni andaj i propozojmë gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta trajtoj si të bazuar dhe të njëjtën ta aprovoj në tërësi gjithashtu që palën e paditur ta obligoj në shpenzimet procedurale dhe atë për një seancë shumën prej 135.20 euro, si dhe për taksë gjyqësore prej 30.00 euro, shuma e përgjithshme prej 165.20 euro.

Gjykata ia ka proceduar këtu të paditurës aktvendimin e datës 02.08.2019 (*për dhënien e përgjigjes së detyrueshme në padi*), padinë dhe provat materiale, të cilat e njëjta i ka pranuar me datë 19.08.2019 (siç vërtetohet nga fletë kthesa e cila gjendet në shkresat e lëndës), mirëpo përgjigjen në padi nuk ka parashtruar.

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike gjykata ka administruar provat si në vijim: ka bërë leximin e kërkesës e drejtuar nga padiësja L. D. për të paditurën Komuna e Gjakovës, DKA me dt.13.06.2019, shikohet vërtetimi i lëshuar nga SBASHK-u, me dt.13.06.2019 dhe i nënshkruar nga kryetari Sali Maliqi, shikohet pasqyra e llogarisë bankare e lëshuar nga TEB Bankë, me dt.18.12.2020, lexohet vërtetimi i lëshuar nga Institucioni para shkollor “. . .” nr.03/01/21 dt.12.01.2021, si dhe vendimi i lëshuar nga Komuna e Gjakovës, DKA nr.04-118/02-13296 dt.25.03.2019.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të lartcekura, në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe ka gjetur se:

Kërkesëpadia e padiësës është pjesërisht e bazuar.

Nga provat e administruara në mënyrë të gjithmbarshme, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të përhershme tek e paditura dhe ka 37 vite e 11 muaj e 3 javë e tre ditë përvojë pune. Paditësja L. D., ka qenë punëtore e arsimit në Institucionin parashkollor “. . .”, në Gjakovë. Me dt.23.04.2019, i është ndërprerë kontrata e punës për shkak të daljes në pension. Paditësja L. D., ka qenë anëtare e Sindikatës së Bashkuar të Arsimit Shkencës deri në pensionim nga Drejtoria e Arsimit në Gjakovë. Po ashtu u vërtetua se paditësja për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor 2018, ka realizuar paga neto prej nga 447.75 €. E paditura, me vendimin e saj 04nr.83 04-118/02-13296 i datës 25.03.2019, këtu paditëses i ka kompensuar pagat përcjellëse për pension në lartësi të 3 pagave të fundit. Paditësja ka kërkuar nga e paditura pagesën e shpërblimit jubilar mirëpo e paditura nuk i ka përmbushur respektivisht nuk ia ka paguar.

Sa i përket bazës së kërkesë-padisë, Gjykata vërtetoi faktin se paditësja ka qenë e punësuar tek e paditura dhe ka përvojë pune 37 vite e 11 muaj e 3 javë e tre ditë, nga dt.30.04.1981 deri me dt.23.04.2019, ku edhe tek e paditura është pensionuar, andaj paditësja me rastin e pensionimit ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shpërblimit jubilar, ndërsa e paditura nuk i është përgjigjur kërkesës së paditëses, andaj duke u bazuar në dispozitat ligjore tek Kontrata Kolektive të Arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, e cila kontratë po me këtë datë ka hyrë në fuqi, sipas së cilës me dispozitat e nenit 35.8 ku citohet se *“Punëtorët që dalin në pension përfitojnë shpërblimin jubilar në vlerë: 8.1 për 10 vjet të përvojës së punës në vlerë 50% të një page bazë. 8.2 për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë 75% të një page bazë. 8.3 për 30 vjet të përvojës së punës në vlerë të një page bazë. 8.4 për 40 vjet të përvojës së punës në vlerë të 150% të një page bazë. 8.5 Shpërblimet jubilarë paguhen nga punëdhënësit ku i punësuari ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse”*. Duka marr parasysh rrethanat e lartcekura Gjykata erdhi në përfundim se kërkesë-padia e paditëses lidhur me shpërblimin jubilar gjykata ia ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses në vlerë të një page të pagës së fundit në shumën prej 447,75 €, ne kuptim të nenin 35.8 pika 8.3 ku për mbi 30 vite të përvojës së punës i takon pagesa në vlerë të një page bazë, për shkak se kjo Gjykatë vërtetoi faktin se paditësja tek punëdhënësi i ka mbi 30 vite përvojë pune, çka do të thotë se kërkesë-padie e paditëses është aprovuar pjesërisht në shumën prej 447.75 € (katërqind e katërdhjetëeshtatë euro e shtatëdhjetë e pesë cent).

Sa i përket lartësisë së kërkesë-padisë Gjykata vendimin e bazoi në provat si; vërtetimi i lëshuar nga Institucioni parashkollor “. . .” – në Gjakovë, me numër të protokollit nr.03/01/21, e dt.12.01.2021, e nënshkruar nga drejtoresha A. S., transaksionet e llogarisë bankare të lëshuar nga TEB-Banka, në emër të paditëses për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, ku paga e fundit në neto ka qenë në shumën prej 447.5 €, andaj Gjykata duke marrë për bazë që paga e paditëses ka qenë 447.75 €, gjykata ka vendosur si në pikën I të dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese respektivisht shumës mbi shumën e aprovuar, për shpërblimin jubilar gjykata të njëjtën e refuzoi ngase konsideroi se shuma e kërkuar mbi shumën e aprovuar është mbi shumën e cila është e paraparë me dispozitat ligjore të kontratës kolektive, pasi që paditësja ka më pak se 40 (dyzetë) vite përvojë pune, respektivisht mbi 37 vite e 11 muaj e 3 javë e tre ditë. Mbi bazën e të lartcekurave, gjykata vlerëson se shuma e kërkuar me kërkesëpadi përtej shumës së aprovuar për shpërblim jubilar, nuk është reale dhe se është në kundërshtim me dispozitat e kontratës kolektive të arsimit në Kosovë e dt.18.04.2017, konkretisht neni 35.8 pika 8.3 i kontratës.

Nga të lartcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është nxjerrë konform nenit 450 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
C.nr.434/19, me datë 01.02.2021

Gjyqtari
Malsor Kryeziu

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.